

VENDIM
Nr. 49, datë 27.1.2021

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
HARTIMIT TË PROJEKTIT TË NDËRHRYJEVE
REHABILITUESE/PËRSHTATËSE, TË NEVOJSHME PËR KTHIMIN E
STRUKTURËS SË OBJEKTEVE, QË JANË KLASIFIKUAR SI OBJEKTE ME
DËMTIME TË MËDHA STRUKTURE OSE DËMTIME SHUMË TË RËNDA
JOSTRUKTURE, NË BASHKINË KAVAJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 73 699 921 (shtatëdhjetë e tre milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet e një) lekë pa TVSH, për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse, të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve, që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore, në Bashkinë Kavajë.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e shtetit për vitin 2021, dhe i transferohet në formën e transfertës së pakushtëzuar Bashkisë Kavajë.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama